


SEWS – CABIND ALBANIA SH.P.K

**Raporti i audituesit të pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe për
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

Aplikant :
Tedi Caburi


PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E PERFORMANCËS DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5 - 30

Toni Bahari
Baba



Ernst & Young Certified Auditors
Albania Branch
NIUS: K61911012I
Rr. Ibrahim Rugova,
Sky Tower, 6th floor
1001, Tirana, Albania

Tel: +35542419575
ey.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin dhe Drejtimin e SEWS-CABIND ALBANIA sh.p.k.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të SEWS-CABIND ALBANIA sh.p.k. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2020, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar Auditimit (SNRF).

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të veçanta të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomalitë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç sa më sipër. Drejtimi dhe personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizem profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencat auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është me i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetedijshme e gjithë informacionit, keq përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmerinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e SEWS-CABIND ALBANIA sh.p.k., përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

Ernst & Young
31 mars 2021
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Auditues Ligjor

Mario Vangjel

Tal Behu
Behu

Deloitte.

Deloitte Albania sh.p.k
Rruga "Faik Konica",
Ndërtesa nr. 6,
Hyrja nr. 7, 1010,
Tirana, Albania

Tel: +355 4 45 17 920
Fax: +355 4 45 17 990
www.deloitte.al

Deklaratë


Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 për shoqërinë Sews – Cabind Albania Sh.p.k me NIPT L92006029C janë hartuar nga shoqëria Deloitte Albania sh.p.k me NIPT J62329003N dhe adresë në Rruga "Faik Konica", Ndërtesa nr.6, Hyrja nr.7, 1010, Tiranë, e regjistruar pranë Institutit të Kontabilisteve të Miratuar (IKM) me përfaqesues ligjor Znj. Violeta Përleka, kontabilist i miratuar me nr. licence 614.

Hartuesi

Deloitte Albania Sh.p.k



DELOITTE ALBANIA
Rr. "Faik Konica", Ndërtesa nr.6 Hyrja Nr.7 1010 Tiranë
Tirana - Albania
Tel: +355 44517 920/ Fax +355 4 45 17990
NIPT: L92006029C N



Teal Cabind

Sews - Cabind Albania Sh.p.k.
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Aktive materiale, neto	5	526,167,235	3,548,057
Aktive jomateriale, neto	6	12,182,824	6,314,262
E drejta e përdorimit të aktiveve, neto	7	207,344,934	261,239,233
Garanci për kontratë qiraje		500,243	492,438
Aktive tatimore të shtyra	8	13,208,306	882,984
Totali i aktiveve afatgjata		759,403,542	272,476,974
Shpenzime të shtyra		1,394,406	167,057
Inventari	9	71,246,620	-
Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit	10	64,529,110	-
Të drejta të arkëtueshme tatimore dhe të tjera	11	73,132,129	1,512,227
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	12	86,878,395	24,423,187
Totali i aktiveve afatshkurtra		297,180,660	26,102,471
Totali i aktiveve		1,056,584,202	298,579,445
KAPITALI			
Kapital aksionar		121	121
Humbja e akumuluar		(18,948,475)	-
Humbja e vitit		(260,265,798)	(18,948,475)
Totali i kapitalit		(279,214,152)	(18,948,354)
DETYRIMET			
Huamarrje nga Shoqëria mëmë	13	470,060,000	36,531,000
Detyrime qiraje afatgjata	14	178,896,812	226,237,345
Totali i detyrimeve afatgjata		648,956,812	262,768,345
Detyrime qiraje afatshkurtra	14	51,585,583	36,803,842
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	15	627,632,836	6,736,944
Të pagueshme për detyrimet tatimore dhe të tjera	16	4,062,513	1,269,463
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		3,560,610	9,949,205
Totali i detyrimeve afatshkurtra		686,841,542	54,759,454
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,056,584,202	298,579,445

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 30 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Ted (brodura)


Sews - Cabind Albania Sh.p.k.
Pasqyra e performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për periudhën nga 06 gusht deri më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	17	48,950,727	
Të ardhura të tjera	18	1,174,430	30,254
Totali i të ardhurave		50,125,158	30,254
Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	19	(69,079,494)	
Shpenzime personeli	20	(38,999,538)	(7,260,164)
Shpenzime amortizimi për aktivet afatgjata materiale	5	(27,217,387)	(45,054)
Shpenzime amortizimi për aktivet afatgjata jomateriale	6	(1,830,513)	(266,788)
Shpenzime amortizimi për të drejtën e përdorimit të aktiveve	7	(42,969,366)	(4,491,191)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	21	(121,034,147)	(8,471,050)
Shpenzime financiare, neto	22	(21,585,833)	672,534
Humbja para tatimit		(272,591,121)	(19,831,459)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	8,23	12,325,323	882,984
Humbja e vitit		(260,265,798)	(18,948,475)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		(260,265,798)	(18,948,475)

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar nga:

Andrea Blinco

 ërfacësues i tijor

SEWS-CABIND ALBANIA
 SHIPK
 NUIS:L92006029C
 Ad: Rruga Erzen, Ballina e Kallit

Akihiro Komori

 Legal representative


Pasqyra e performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 30 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Sews - Cabind Albania Sh.p.k.
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

	Kapitali aksionar	Rezerva të tjera	Humbje e mbartur	Totali
Gjendja më 06 gusht 2019	121	-	-	121
Humbja e vitit	-	-	(18,948,475)	(18,948,475)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	121	-	(18,948,475)	(18,948,354)
Gjendja më 01 janar 2020	121	-	(18,948,475)	(18,948,354)
Humbja e vitit	-	-	(260,265,798)	(260,265,798)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	121	-	(279,214,273)	(279,214,152)

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 30 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



(te gjitha shumat jane te shprehura ne Lek)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për periudhën nga 06 gusht deri më 31 dhjetor 2019
Aktiviteti operativ		
Fitimi para tatimit	23	(272,591,121)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		(19,831,459)
Amortizimi i aktiveve materiale dhe jomateriale	5,6	34,389,018
Amortizimin e aktiveve me të drejtë përdorimi	7	53,894,298
Shpenzime interesi		14,004,365
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Ndryshim në të drejtat e arkëtueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	10	(64,529,110)
Ndryshim në të drejtat e arkëtueshme tatimore dhe të tjera	11	(71,627,707)
Ndryshim në shpenzimet e shtyra		(1,227,349)
Ndryshim në detyrimet tatimore dhe të tjera	15,16	621,072,767
Ndryshim në të pagueshme për shpenzime të konstatuara		(6,388,593)
Ndryshim në inventarë	9	(71,246,620)
Interesa të paguara	14	(11,388,190)
Fluksi i mjete monetare gjeneruar nga aktiviteti operativ		224,361,758
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	5	(555,177,684)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	6	(7,699,074)
Fluksi i mjeteve monetare i përdorur në aktivitetin investues		(562,876,758)
Huamarrje nga Shoqëria mëmë	13	433,529,000
Detyrimi i qirasë	14	(32,558,792)
Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar nga aktiviteti financues		400,970,208
Rritja neto në mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre		62,455,208
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit	12	24,423,187
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit	12	86,878,395

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 30 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Sews Cabind Albania Sh.p.k (“Shoqëria”) është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L92006029C, në datën 06 gusht 2019, me numër rregjistrimi fillestar CN-301400-08-19. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit “Për Shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe nga statuti i saj.

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë konsiston në prodhimin e telave dhe kablllove, pjesë përbërëse të sistemit elektronik dhe elektrik të automjeteve, të cilat eksportohen më pas tek palët e lidhura brenda Grupit.

Gjate vitit 2019 Shoqëria ka qenë në fazën e themelimit të saj në Shqipëri, ku deri në 31 dhjetor 2019, procesi i instalimit të makinerive, rekrutimi i stafit dhe trajnimi i tyre nuk ka përfunduar plotësisht, dhe si rrjedhojë edhe aktiviteti i prodhimit nuk ka filluar.

Gjatë vitit 2020, Shoqëria vazhdoi me procesin e instalimit të makinerive dhe linjës së prodhimit, ndërkohë është ende në proces për rekrutimin e stafit dhe trajnimin e tyre për operacionet e prodhimit. Gjatë vitit 2020 Shoqëria ka filluar aktivitetin e saj prodhues.

Selia e Shoqërisë ndodhet në rrugën “Erzen”, Bathore, Kamëz, Tiranë. Shoqëria zotërohet tërësisht (100%) nga shoqëria Sews Cabind S.p.A, me seli qendrore në Collegnio, Torino, Itali. Aktiviteti ekonomik i Shoqërisë mëmë konsiston në prodhimin dhe shitjen e sistemeve elektronike dhe elektrike të automjeteve për klientët e saj kryesorë si FCA dhe CNH Industrial (Iveco, Case New Holland Ltd).

Shoqëria mëmë Sews - Cabind S.p.A, që nga viti 2014 zotërohet 60% nga SEI Group (Sumitomo Electric Industries Ltd), themeluar në 1897, me seli në Osaka, Japoni dhe 40% nga SWS (Sumitomo Wiring System Ltd).

Përfaqësues ligjor i Shoqërisë është Z.Andrea Blanco. Shoqëria më 31 dhjetor 2020 ka deklaruar 262 punëmarrës.

2. BAZA E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) siç janë lëshuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (IASB).

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është edhe monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet kryesore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

2. BAZA E PËRGATITJES (VAZHDIM)

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Në vecanti, informacioni mbi elemente të rëndësishëm të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël që kanë një efekt shumë të rëndësishëm në shumën e njohur në pasqyrat financiare, përshkruhet në shënimet shpjeguese përkatëse të pasqyrave financiare. Gjatë fillimit të vitit 2020, pandemia e COVID-19 u përhap në të gjithë botën. Në Mars 2020, Qeveria Shqipëtare mori masa drastike duke pezulluar shumë aktivitete biznesi. Në atë periudhë, Shoqëria ishte ende në procesin e instalimit të makinerive dhe linjës së prodhimit, rekrutimin e stafit dhe trajnimin e tyre për operacionet e prodhimit. Impianti qëndroi i mbyllur vetëm për 2 javë dhe pasi ishin dhënë lejet e nevojshme aktiviteti i Shoqërisë rifilloi. Edhe pse situata pandemike ngadalësoi operacionet dhe ndikoi në kapacitetin optimal të prodhimit për vitin 2020, ajo nuk rezultoi të jetë një pengesë e madhe që do të kërkonte një rishikim të gjykimeve dhe vlerësimeve nga Drejtimi i Shoqërisë. Përsa i përket buxhetimit të vitit 2021, njësia ekonomike parashikon të arrijë kapacitetin optimal të prodhimit dhe menaxhimin e dëshiruar të kostos dhe po planifikon hapjen e një fabrike të re për një projekt të ri i cili do të kërkojë hyrje të reja në drejtim të pajisjeve dhe makinerive dhe gjithashtu instalimeve teknike (panele elektrike, kondicionimi i ajrit, etj).

Jetëgjatësia e dobishme e aktiveve afatgjata materiale: Vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale, është një çështje gjykimi bazuar në përvojën me asetet e ngjashme. Përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me asetet konsumohen kryesisht përmes përdorimit. Sidoqoftë, faktorë të tjerë, të tilla si vjetërsimi teknik ose tregtar dhe konsumimi, shpesh rezultojnë në zvogëlimin e përfitimit ekonomike të lidhura me asetet. Drejtimi vlerëson jetën e dobishme të mbetur në përputhje me kushtet aktuale teknike të aktiveve dhe periudhën e vlerësuar gjatë së cilës aktivitetet priten të gjenerojnë përfitime për Shoqërinë. Janë konsideruar si faktorët kryesorë si vijon: (a) përdorimi i pritur i asetëve; (b) konsumimin e pritur fizik, i cili varet nga faktorët operacionalë dhe programi i mirëmbajtjes; dhe (c) vjetërsimi teknik ose tregtar që rrjedh nga ndryshimet në kushtet e tregut.

Tatimi mbi të ardhurat: Drejtimi, pavarësisht pasigurisë së mjedisit shqiptar fiskal dhe legjislacionit ekzistues në fuqi beson se llogaritja e tatimit mbi të ardhurat është e përshtatshme për të gjitha vitet aktive fiskale bazuar në vlerësimin e tij të shumë faktorëve, përfshirë interpretimet e legjislacionit tatimor dhe përvojën e mëparshme, dhe që çdo kontroll i ardhshëm tatimor nuk do të ketë një efekt të rëndësishëm në pozicionin financiar të Shoqërisë, rezultatet e operacioneve ose flukset monetare. Sidoqoftë, për shkak të natyrës së ligjit të tatimit mbi të ardhurat, praktikat dhe udhëzimet e ndërlidhura nuk është e mundur të sigurohet që pozicioni aktual i ligjit tatimor do të mbetet i pakontestueshëm nga autoritetet tatimore.

2.5 Parimi i vijimësisë

Pandemia Covid-19 rezultoi në një ndikim të rëndësishëm ekonomik dhe social në Shqipëri dhe globalisht, megjithatë Shoqëria ishte në gjendje të përgjigjej shpejt dhe mori masat e nevojshme për të mos ngrirë aktivitetin për një periudhë të gjatë. Pandemia ngadalësoi operacionet, por nuk rezultoi me efekte të forta negative të cilat do të rezultonin në supozime dhe vlerësime që kërkojnë rishikime, ose mund të çojnë në rregullime materiale të vlerës së mbetur të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit të ardhshëm financiar. Për më tepër, në datën e këtyre pasqyrave financiare, Shoqëria siguron përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kushteve të rëna dakord për dymbëdhjetë muajt e ardhshëm. Pjesa më e madhe e detyrimeve tregtare dhe financiare janë ndaj Grupit dhe bazuar në marrëveshjet brenda grupit, këto detyrime mund të kompensohen me balancat e papaguara të llogarive të arkëtueshme prej tyre. Plani financiar 5 vjeçar i azhurnuar së fundmi dhe buxheti i vitit të ardhshëm parashikon një rritje në investime dhe në kapacitetin e prodhimit. Për këtë arsye, Shoqëria vazhdon të zbatojë supozimin e parimit të vijimësisë së biznesit dhe pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me këtë parim. Në këtë gjykim, Shoqëria mori parasysh pozicionin financiar të Shoqërisë mëmë, objektivat aktuale, dhe aksesin në burimet financiare.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL**3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit janë njohur në pasqyrën e performancës.

Zërat jo monetarë nuk konvertohen në fund të vitit dhe maten në bazë të kostos historike (konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit), përveç zërave jo monetare të matur me vlerën e drejtë të cilët konvertohen me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën e raportimit, është si vijon:

	Kursi i këmbimit më 31 dhjetor 2020	Kursi i këmbimit më 31 dhjetor 2019
Kursi në datën e raportimit ALL / EUR	123.70	121.77
Kursi mesatar ALL / EUR	123.78	123.00

3.2 Qiratë*(i) E drejta e përdorimit te aktivitetit*

Shoqëria ka marrë me qira ndërtesën që përdoret si fabrikë dhe automjetet që përdoren për qëllimet e aktivitetit të saj ekonomik.

E drejta e përdorimit te aktiveve maten me kosto, minus çdo zhvlerësim të akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi dhe rregullohen për çdo ri-matje të pasiveve të qirasë.


Kostoja e të drejtës së përdorimit te aktivitetit përfshin:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë;
- çdo pagesë qiraje e bërë në ose para datës së fillimit minus çdo stimul i marrë nga qiraja;
- çdo kosto fillestare direkte, dhe
- kostot për të rikthyer aktivin në kushtet e kërkuara nga marrëveshjet e qirasë.

(ii) Amortizimi

E drejta e përdorimit te aktivitetit përgjithësisht zhvlerësohet për periudhën më të hershmes ndërmjet jetës së dobishme të aktivitetit dhe afatit të qirasë mbi një bazë lineare. Nëse Shoqëria ka baza të sigurta për të ushtruar një opsion blerjeje, aktivi i së drejtës së përdorimit zhvlerësohet gjatë jetës së dobishme të aktiveve. Amortizimi i zërave të aktiveve të së drejtës së përdorimit në lidhje me ndërtesat dhe automjetet llogaritet duke përdorur metodën lineare sipas kushteve të kontratës së qirasë.

	<u>Jeta e dobishme në vite</u>
Ndërtesa	5
Automjete	3

Tedi Borshu


3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Qiratë (vazhdim)

(iii) Detyrimi i qirasë

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njihet detyrimet e qirasë të matura me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që duhen bërë gjatë afatit të qirasë. Pagesat e qirasë përfshijnë:

- pagesa fikse (përfshirë pagesat fikse në substancë), minus çdo stimul i qirasë së arkëtueshme,
- pagesa e ndryshueshme e qirasë që bazohet në një indeks ose një normë, e matur fillimisht duke përdorur indeksin ose normën në datën e fillimit,
- shumat që pritet të paguhen nga Shoqëria nën garancitë e vlerës së mbetur,
- çmimi i ushtrimit të një opsioni blerje nëse Shoqëria në mënyrë të arsyeshme është e sigurt për të ushtruar atë mundësi., dhe
- pagesa të penaliteteve për përfundimin e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron Shoqërinë që ushtron atë opsion.

Pagesat e qirasë zbriten duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, përdoret norma rritëse e huamarrjes së Shoqërinë, duke qenë norma që Shoqëria do të duhet të paguajë për të marrë hua fondet e nevojshme për të marrë një aktiv me vlerë të ngjashme, në një mjedis ekonomik me terma, kolateral dhe kushte të ngjashme.

Për të përcaktuar normën rritëse të huamarrjes, Shoqëria zbaton normën e publikuar nga Banka e Shqipërisë për huazimet në euro për pasuri të paluajtshme dhe blerjen e pajisjeve, me një maturim prej 3 deri në 5 vjet. Pagesat e qirasë gjatë gjithë periudhës 5-vjeçare të kontratës për ndërtesën janë të ndryshueshme dhe ndryshojnë në bazë të çmimit për metër katror të sipërfaqes siç është rënë dakord nga palët, duke marrë parasysh çmimet e referencës për qira të ndërtesave për qëllime tatimore, sipas legjislacionit përkatës. Pagesat e qirasë për kontratën e automjeteve janë pagesa fikse mujore.

Pas datës së fillimit, shumat e detyrimeve të qirasë rritet për të reflektuar akumulimin e interesit dhe zvogëlohet për pagesat e kryera të qirasë.

Për më tepër, vlera kontabël e detyrimeve të qirasë ri-matet nëse ka një modifikim, një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë (p.sh., ndryshimet në pagesat e ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks ose normë të përdorur për të përcaktuar të tilla pagesa të qirasë) ose një ndryshim në vlerësimin e një opsioni për të blerë aktivin themelor.

Pagesat e qirasë alokohen midis kostos kryesore dhe asaj financiare. Kostot e financimit ngarkohen në fitim ose humbje gjatë periudhës së qirasë në mënyrë që të prodhojnë një normë konstante periodike interesi për pjesën e mbetur të detyrimit për secilën periudhë.

Pagesat e lidhura me qira afatshkurtra dhe qira të aktiveve me vlerë të ulët njihen në bazë lineare si një shpenzim në fitim ose humbje. Qira afatshkurtra janë qira me afat qiraje prej 12 muajsh ose më pak. Asetet me vlerë të ulët janë asetet me një vlerë prej 5,000 Eur ose më pak.

(iv) Përcaktimi i afatit të qirasë së kontratave me opsionet e rinovimit dhe përfundimit

Shoqëria përcakton afatin e qirasë si termin e pa-anulueshëm të qirasë, së bashku me çdo periudhë të mbuluar nga një opsion për të zgjatur qiranë nëse ka baza të sigurt për t'u ushtruar, ose ndonjë periudhë e mbuluar nga një opsion për të përfunduar qiranë, nëse ka baza të arsyeshme që të mos ushtrohet.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**3.2 Qiratë (vazhdim)**

(iv) *Përcaktimi i afatit të qirasë së kontratave me opsionet e rinovimit dhe përfundimit (vazhdim)*

Në lidhje me kontratën e qirasë për ndërtesën, qiradhënësi ka të drejtë të njoftojë qiramarrësin jo më vonë se 1 vit para skadimit të afatit të qirasë. Rinovimi do të jetë për të paktën 5 vjet, në varësi të kushteve dhe kushteve të njëjta të përcaktuara në marrëveshjen ekzistuese.

Shoqëria ka disa kontrata qiraje që përfshijnë mundësi zgjatjeje dhe përfundimi. Shoqëria zbaton gjykimin në vlerësimin nëse ka baza të sigurta nëse do të ushtrojë opsionin për rinovimin ose përfundimin e qirasë. Kjo do të thotë, se shqyrton të gjithë faktorët relevantë që krijojnë një nxitje ekonomike për të që të ushtrojë rinovimin ose përfundimin e kontratës. Pas datës së fillimit, Shoqëria rivlerëson afatin e qirasë nëse ka një ngjarje të rëndësishme ose ndryshim të rrethanave që është brenda kontrollit të saj dhe ndikon në aftësinë e saj për të ushtruar ose jo për të ushtruar mundësinë e rinovimit ose të ndërprerjes.

3.3 Aktivet afatgjata materiale

(i) *Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kostoja historike përfshin shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktivitetit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivitetit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes të kapitalizuara për aktivitetin.

(ii) *Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të zërit në qoftë së është e mundur që në të ardhmen përfitimet ekonomike të përfshira në atë zë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e performancës kur ndodhin. Kostoja e zëvendësimit të pjesëve kryesore ose përbërësve të sendeve të pronës, impianteve dhe pajisjeve kapitalizohet dhe pjesa e zëvendësuar nxirret jashtë përdorimit.

(iii) *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetëgjatësinë e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material, duke filluar nga dita e parë e muajit në të cilin vihet në përdorim. Normat e amortizimit të përdorura nga Shoqëria janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Norma e Amortizimit
Makineri prodhimi	15.5% dhe 25%
Mobilje dhe pajisje zyre	12%
Instalimi i sistemit IT dhe pajisje kompjuterike	20%
Instalime teknike, makineri, mjete dhe pajisje teknike specifike, instrumente	15.5%
Pajisje informative	20%
Përmirësimet për aktive të marra me qira	Me e vogla midis jetëgjatësisë se aktivitetit dhe kohëzgjatjes së kontratës

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jo materiale, të cilat konsistojnë tërësisht në programe kompjuterike, paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën lineare. Norma e amortizimit e përdorur për aktivitet afatgjata jo materiale është 20%. Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportimi dhe efektet e ndonjë ndryshimi në vlerësim rregjistrohen në bazë prospective.

3.5 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jo financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë, janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Humbja nga zhvlerësimi njihet në qoftë se vlera e mbartur e aktivitet e kalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në pasqyrën e performancës.

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësisë së tij gjeneruese të parasë, tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Njësia gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron rrjedhje parash që janë të pavarura nga aktivitet dhe grupet e tjera. Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose një njësie gjeneruese të parasë, është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhja e pritshme e ardhshme e parasë është skontuar në vlerën aktuale duke përdorur normën e skontimit që reflekton vlerën aktuale të parasë në treg dhe rreziqet specifike të aktivitet. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka tregues që humbja nga zhvlerësimi nuk ekziston më dhe që ka patur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme.

3.6 Inventari

Inventarët e Shoqërisë përbëhen nga lëndë të parë, prodhim në proces dhe produkte të gatshme. Inventarët maten me koston më të ultën midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit përcaktohet duke përdorur metodën FIFO. Kostoja e inventarëve do të përfshijë të gjitha kostot e blerjes, kostot e konvertimit dhe kostot e tjera të kryera për të sjellë inventarët në vendin dhe gjendjen e tyre aktuale.

Kostot e blerjes së inventarëve përfshijnë çmimin e blerjes, detyrimet e importit dhe taksat e tjera (përveç atyre që më vonë mund të rikuperohen nga njësia ekonomike nga autoritetet tatimore), dhe transportin, trajtimin dhe kostot e tjera që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së artikujve të inventarit.

Kostot e përpunimit të inventarëve përfshijnë kosto që lidhen drejtpërdrejt me njësitë e prodhimit, siç është puna direkte. Ato gjithashtu përfshijnë një alokim sistematik të shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit fikse dhe variabël që janë bërë gjatë konvertimit të materialeve në mallra të gatshme. Alokimi i shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit fikse për kostot e përpunimit bazohet në kapacitetin normal të pajisjeve të prodhimit.

Kostot e tjera përfshihen në koston e inventarëve vetëm deri në shkallën që ato kryhen për t'i sjellë inventarët në vendndodhjen dhe kushtet aktuale.

Kur inventarët konsumohen, vlera e tyre e mbetur njihet si shpenzim në periudhën në të cilën e ardhura përkatëse njihet. Shuma e rënies në vlerë të inventarëve deri në vlerën e realizueshme neto si dhe të

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.6 Inventari (Vazhdim)

gjitha humbjet nga inventarët njihen si shpenzime në periudhën në të cilën rënia në vlerë apo humbja ndodh.

Shoqëria ka mbajtur inventarë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 që konsistojnë kryesisht në materiale të para, prodhim në proces si dhe produkte të gatshme për tu shitur. Gjithashtu, në zërat e inventarit Shoqëria ka edhe materiale të tjera ndihmëse për prodhim.

3.7 Instrumentat financiarë

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv financiar ose një instrument kapitali të një njësie ekonomike tjetër.

Aktiv Financiar

(i) Njohja dhe matja fillestare

Aktivët financiarë klasifikohen, në njohjen fillestare, siç maten më pas me koston e amortizuar, vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ) dhe vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDFH).

Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat kontraktuale të fluksit të mjeteve monetare të pasurisë dhe modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e tyre. Me përjashtim të të arkëtueshmeve tregtare që nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi ose për të cilat Shoqëria ka aplikuar mjetin praktik, Shoqëria fillimisht mat një aktiv financiar në vlerën e tij të drejtë plus, në rastin e një aktivi financiar jo me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit. Të arkëtueshmet tregtare që nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi ose për të cilin Shoqëria ka aplikuar përshtatshmërinë praktike maten me çmimin e transaksionit të përcaktuar në SNRF 15.

Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), ai duhet të krijojë flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën e principalit të papaguar. Ky vlerësim referohet si testi SPPI dhe kryhet në një nivel instrumenti. Aktivët financiarë me flukse parash që nuk janë SPPI klasifikohen dhe maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, pavarësisht nga modeli i biznesit.

Modeli i biznesit i Shoqërisë për menaxhimin e aktiveve financiare i referohet mënyrës se si ajo administron pasuritë e saj financiare në mënyrë që të gjenerojë flukse parash. Modeli i biznesit përcakton nëse flukset e parave do të rezultojnë nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale, shitja e aktiveve financiare ose të dyja. Aktivët financiarë të klasifikuara dhe të matura me koston e amortizuar mbahen brenda një modeli biznesi me qëllim të mbajtjes së aktiveve financiare në mënyrë që të mbledhin flukse monetare kontraktuale ndërsa mjetet financiare të klasifikuara dhe të matura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ) mbahen brenda një modeli biznesi me objektivin e të dyve mbajtja për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe shitja. Blerjet ose shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e aktiveve brenda një afati kohor të vendosur nga rregullorja ose konventa në treg (tregtimi në mënyrat e zakonshme) njihen në datën e tregtimit, d.m.th., datën që Shoqëria zotohet të blejë ose shesë aktivin.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.7 Instrumentat financiarë (vazhdim)

(ii) Klasifikimi dhe matja vijuese

Për qëllime të matjes vijuese, aktivet financiare klasifikohen në katër kategori:

- Aktive financiare me kosto të amortizuar (instrumente borxhi);
- Asetet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ) me riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentet e borxhit);
- Asetet financiare të përcaktuara me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ) pa riciklim të fitimeve dhe humbjeve kumulative gjatë çregjistrimit (instrumentet e kapitalit);
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDFH).

Shoqëria mban aktive financiare të kategorisë së parë, të cilat janë përmbledhur në detaje më poshtë.

Aktive financiare me kosto të amortizuar (instrumente borxhi)

Aktivitetet financiare me kosto të amortizuar më pas maten duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe janë subjekt i zhvlerësimit. Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivi çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet. Aktivitetet financiare të Shoqërisë me kosto të amortizuar përfshijnë të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera dhe ekuivalentet e mjeteve monetare.

(iii) Zhvlerësimi

Shoqëria njih një provizion për humbjet e pritshme të kredisë për të gjithë instrumentet e borxhit që nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes. Humbjet e pritshme të kredisë bazohen në diferencën midis flukseve të mjeteve monetare kontraktuale në përputhje me kontratën dhe të gjitha flukseve të parave që Shoqëria pret të marrë, skontuar deri në një përafrim të normës origjinale të interesit efektiv.

Për të arkëtueshmet tregtare dhe aktivet kontraktuale, Shoqëria zbaton një qasje të thjeshtuar në llogaritjen e humbjeve të pritshme të kredisë. Prandaj, Shoqëria nuk gjurmon ndryshimet në rrezikun e kredisë, por përkundrazi njih një kompensim të humbjes bazuar kohëzgjatjen e humbjeve të pritshme të kredisë në datën e raportimit. Shoqëria kryen shitje ndaj palëve të saj të lidhura për të cilat periudha e mbledhjes së kredisë është deri në 90 ditë nga data e transaksionit.

4. Fshirja

Aktivitetet financiare janë shlyer, tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka shteruar të gjitha përpjekjet praktike për arkëtim dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka ndonjë pritje të arsyeshme të rikuperimit. Fshirja përfaqëson një çregjistrim. Shoqëria mund të fshijë aktivitetet financiare që janë ende subjekt i veprimtarisë së arkëtimit kur Shoqëria kërkon të rikuperojë shumat që i detyrohen sipas kontratës, por megjithatë, nuk ka pritje të arsyeshme të rikuperimit.

5. Çregjistrimi

Shoqëria çregjiston një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parave në një transaksion në të cilin janë të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar janë transferuar ose në të cilën Shoqëria as transferon, as ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar.

Shoqëria hyn në transaksione me të cilat transferon aktivitetet e njohura në pasqyrën e pozicionit të saj financiar, por ruan ose të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në këto raste, pasuritë e transferuara nuk çregjistrohen.

12
Tos, Gahuro
Baba

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.7 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Detyrimet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Detyrimet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, si detyrime financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, hua dhe huazime, pagesa të pagueshme, ose si derivativë të përcaktuar si instrumente mbrojtës në një mbrojtje efektive, siç është e përshtatshme.

Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e huave dhe huazimeve dhe të pagueshme, neto nga kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt.

Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë tregti dhe të pagueshme të tjera dhe hua nga palët e lidhura.

(ii) Klasifikimi dhe matja pasuese

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, siç përshkruhet më poshtë:

- Detyrimet financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes;
- Detyrimet financiare me kosto të amortizuar (hua dhe huazime).

Shoqëria nuk klasifikon asnjë pasiv financiar në vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes.

(iii) Çregjistrimi

Një pasiv financiar çregjistrohet kur detyrimi nën pasiv shkarkohet ose anulohet ose skadon.

Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivitet dhe pasivitet financiar janë kompensuar dhe shuma neto është raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e zbatueshme nga ligji për të kompensuar shumat e njohura, dhe ekziston një qëllim që ose të shlyhet në një bazë neto, ose të realizohet aktivi dhe shlyhet detyrimin njëkohësisht. Një e drejtë e tillë e shlyerjes (a) nuk duhet të varet nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë e zbatueshme ligjërisht në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast të mospagimit dhe (iii) në rast të paaftësia paguese ose falimentimi.

3.8 Kapitali aksionar

Gjatë vitit 2020, Shoqëria ka kapital aksionar në vlerën prej 1 euro nga kontributet në para të themeluesve të saj. Kapitali aksionar është konvertuar nga monedha e huaj në monedhën lek, duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Kapitali aksionar i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale.

3.9 Njohja e të ardhurave

Shoqëria është në biznesin e prodhimit të telave dhe kablllove, një pjesë integrale e sistemit elektronik dhe elektrik të automjeteve, të cilat më pas eksportohen te klientët e saj jashtë vendit.

Të ardhurat nga kontratat me klientët njihen kur kontrolli i mallrave ose shërbimeve i transferohet klientit në një shumë që reflekton konsideratën për të cilën Shoqëria pret të ketë të drejtë në këmbim të atyre mallrave ose shërbimeve. Të ardhurat nga shitja e produkteve të gatshme dhe mallrave njihen në momentin kur kontrolli i mallrave është transferuar, duke qenë se mallrat i dorëzohen klientit, klienti ka zotërim të plotë mbi mallrat dhe nuk ka asnjë detyrim të papërbushur që mund të ndikojë në pranimin e mallrave nga klienti. Dorëzimi ndodh kur mallrat janë transportuar ose transportuar në vendin specifik, rreziqet e vjetërsimit dhe humbjes i janë transferuar klientit dhe ose klienti i ka pranuar

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.9 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

mallrat në përputhje me kontratën, dispozitat e pranimit kanë kaluar ose Shoqëria ka dëshmi objektive se të gjitha kriteret për pranim janë përmbushur.

Shoqëria konsideron nëse ka premtime të tjera në kontratë që janë detyrime të veçanta të performancës për të cilat duhet të ndahet një pjesë e çmimit të transaksionit (p.sh., garancitë, pikat e besnikërisë së klientit). Gjatë përcaktimit të çmimit të transaksionit për shitjen e mallrave, Shoqëria konsideron efektet e vlerësimit të ndryshueshëm, ekzistencën e komponentëve të rëndësishëm të financimit, shumën jo të parave të gatshme dhe shumën e pagueshme klientit (nëse ka).

Shoqëria nuk ka ndonjë vlerësim të ndryshueshëm.

Asnjë element i financimit nuk konsiderohet i pranishëm pasi shitjet bëhen me një afat kredie nga 0-30 ditë, gjë që është në përputhje me praktikën e tregut. Një e arkëtueshme njihet kur mallrat dorëzohen pasi kjo është pika në kohë që konsiderimi është i pakushtëzuar sepse kërkohet vetëm kalimi i kohës para se të paguhet pagesa.

Më tej, Shoqëria vlerëson nëse në kontratat me klientët, ajo luan rolin e Principalit ose Agjentit. Ky vlerësim bëhet në nivelin e kontratës ose grupit të kontratave të ngjashme. Shoqëria realizon të gjitha shitjet sipas kushteve të kontratës DAP (Dorëzuar në Vend) ku kalon kontrolli pasi produktet janë dorëzuar në portin e mbërritjes. Për këto kushte të kontratës, detyrimi i vetëm i performancës është dorëzimi i produktit deri në pikën ku do të transferohet kontrolli.

Kushtet e tjera të kontratave që nuk janë përdorur në vitin aktual por mund të përdoren në të ardhmen janë:

- FOB (Liruar në bord) të cilët nuk e ngarkojnë atë me përgjegjësinë për sigurimin e transportit ose shërbimit të sigurimit, pasi mallrat ngarkohen në portin e nisjes;
- shitjet sipas kushteve të kontratës CFR (Kostoja dhe Transporti) ose CIF (Sigurimi i Kostos dhe Transportit), ku kalon kontrollin e produktit të shitur klientit në momentin e ngarkimit në anije (si kryesor) që korrespondon deri në datën në të, e cila ka transferuar kontrollin tek klienti, por në të njëjtën kohë është e angazhuar për të siguruar shërbimin e transportit (si agjent) në të cilin ka përmbushur detyrimet e transportit për klientin që përkon me një moment të caktuar kur mbaron transporti. Në këtë mënyrë Shoqëria ka një detyrim të performancës për shërbimin e transportit i cili ofrohet vetëm për të lehtësuar shitjen e produktit.

Asetet e kontratës

Një aktiv i kontratës është e drejta e vlerësimit në këmbim të mallrave ose shërbimeve të transferuara te klienti. Nëse Shoqëria kryen duke transferuar shërbime te një klient para se klienti të paguajë shumën ose para se të paguhet pagesa, një aktiv i kontratës njihet për shumën e fituar që është e kushtëzuar.

Të arkëtueshmet tregtare

Një e arkëtueshme njihet nëse një shumë e shumës që është e pakushtëzuar duhet të paguhet nga klienti (d.m.th., kërkohet vetëm kalimi i kohës para se të paguhet pagesa e shumës).

14
Felix Bachmann
Felix

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

Detyrimet e kontratës

Një detyrim i kontratës është detyrimi për të transferuar mallra ose shërbime tek një klient për të cilin Shoqëria ka marrë shpërblim (ose një shumë e shumës është e pagueshme) nga klienti. Kur klientët paguajnë konsideratë para se Shoqëria të transferojë mallra ose shërbime te konsumatori, detyrimet e kontratës në formën e parapagimeve njihen kur pagesa bëhet. Detyrimet e kontratës njihen si të ardhura kur Shoqëria dorëzon mallrat.

Detyrimet e kontratës janë më shumë të natyrës operacionale dhe nuk kanë një komponent të rëndësishëm financimi.

3.10 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera operative përfshijnë të ardhura që nuk gjenerohen rregullisht gjatë rrjedhës normale të aktivitetit ekonomik, përfshirë fitimet nga shitja e elementeve të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, shitja e skrapit etj.

3.11 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Shoqëria, në rrjedhën normale të biznesit të saj, bën pagesa në emër të saj dhe në emër të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet e detyrueshme sipas legjislacionit vendor. Kostot e bëra në emër të Shoqërisë ngarkohen në fitim dhe humbje kur ndodhin.

Sigurimi shëndetësor i punonjësve

Shoqëria gjithashtu ka zbatuar një plan të sigurimit shëndetësor të punonjësve. Kontributi i paguhet një shoqërie sigurimesh në përpjesëtim me shërbimet e dhëna Shoqërisë nga punonjësit dhe regjistrohet si një shpenzim nën 'Shpenzimet e Personelit'. Shoqëria bën pagesa fikse për çdo punonjës në bazë vjetore dhe nuk ka ndonjë detyrim tjetër ndaj planit të sigurimit shëndetësor në fund të vitit.

3.12 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyrë

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e performancës, përveç rasteve kur lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen fiskale të vitit, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin është 15%.

Duke filluar nga 01 janar 2020 norma e tatimit mbi fitimin e aplikueshme për personat juridike që operojnë në industrinë automotive është 5% e të ardhurës së tatueshme. Shoqëria parashikon të përbushë të gjithë kriteret e ligjit për të aplikuar normën e reduktuar 5%. Gjithashtu, bazuar në këto ndryshime në legjislacionin fiskal, personat juridikë që kryejnë investime me vlerë mbi 1 miliardë lekë, kanë të drejtë të mbartin humbjet tatimore për një periudhë deri në 5 vjet. Duke qenë se vlera e përgjithshme e investimit kalon 1 miliardë lekë, Shoqëria plotëson kushtin e lartpërmendur dhe si rrjedhojë ka të drejtën të mbartë humbjen fiskale deri në 5 vjet.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.12 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyrë (continued)

Tatimi i shtyrë njihet duke paraqitur diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Në periudhën raportuese, Shoqëria ka konstatuar diferenca në normat e amortizimit të përdorura për qëllime kontabël me normat e amortizimit të përcaktuara nga legjislacioni tatimor. Shoqëria ka njohur aktiv tatimor të shtyrë për humbjen fiskale që do të rikuperohet në periudhat e ardhshme tatimore. Në njohjen e këtij aktivi tatimor të shtyrë, Shoqëria është bazuar në planin e investimit të saj, sipas të cilit kjo humbje do të rikuperohet brenda harkut kohor prej 5 vitesh, ku Shoqëria parashikon që do të rezultojë me fitim. Llogaritjet e tatim fitimit të shtyrë janë realizuar duke marrë në konsideratë ndryshimet në legjislacionin tatimor të përmendura më sipër në lidhje me normën e tatimit mbi fitimin e aplikueshme për industrinë automotive dhe periudhën e mbartjes së humbjeve.

3.13 Provizionet

Provizionet njihen kur si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime (ligjore ose konstruktive) të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit.

Nëse efekti është material, provizionet janë përcaktuar duke u zbritur vlerën e pritshme të rrjedhës së mjeteve monetare të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimeve. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më mundësi që një rrjedhje burimesh që përfshin përfitime ekonomike për shlyerjen e detyrimit, të jetë e nevojshme për mbylljen e detyrimit, provizionet rimerren. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht. Nuk njihet provizion për humbjet e ardhshme operative.

3.14 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga Shoqëria mëmë Sews Cabind S.p.A, së bashku me entitetet e tjera që e kontrollojnë ose kontrollohen prej saj . Në marrjen në konsideratë të çdo marrëdhënie të mundshme me palët e lidhura, vëmendja i drejtohet thelbit të marrëdhënies, jo vetëm formës ligjore.

3.15 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por jepet informacion në shënime të pasqyrave financiare, për atë kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Aktivitetet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por jepet informacion shpjegues për atë kohë sa ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

3.16 Standarde të reja dhe ndryshime të standarteve ekzistuese të publikuara ende të pa-adoptuara

- SNRF 17 "Kontratat e sigurimit" përfshirë përmirësimet e SNRF 17 (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023);

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.16 Standarde të reja dhe ndryshime të standarteve ekzistuese të publikuara ende të pa-adoptuara (vazhdim)

- Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit" – Referencë e Kuadrit Konceptual me përmirësimet e SNRF 3, (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022);
- Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e sigurimit" – Zgjatje e Përjashtimeve të përkohshme nga aplikimi i SNRF 9 (data e mbarimit për përjashtimet e përkohëshme nga SNRF 9 u zgjat në periudha vjetore duke nisur në ose pas 1 janar 2023);
- Ndryshimet në SNRF 10 "Konsolidimi i pasqyrave financiare" dhe SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta" - Shitja ose Kontributi i Aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose ndërmarrjes së përbashkët dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive e shtyrë për një kohë të pacaktuar deri në përfundimin e projektit kërkimor mbi metodën e kapitalit);
- Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë"- Koncesionet e Qirasë në lidhje me Covid-19 (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 qershorit 2020. Lejohet zbatimi i mëparshëm, përfshirë pasqyrat financiare që nuk janë autorizuar ende për tu lëshuar në 28 maj 2020. Ndryshimi është gjithashtu i disponueshëm për raportet e ndërmjetme);
- Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare" - Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurta ose afatgjata (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023);
- Ndryshimet në SNK 16 "Prona, makineri dhe pajisje" - Të ardhura para përdorimit të synuar (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022);
- Ndryshimet në SNK 37 "Provizione, detyrime të kushtëzuara dhe aktive të kushtëzuara" - Kontrata në vazhdimësi - Kostoja e përbushjes së një kontrate (efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2022);
- Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiarë", SNK 39 "Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja" dhe SNRF 7 "Instrumentet Financiarë: Shënimet Shpjeguese" SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit" dhe SNRF 16 "Qira" - Reforma e Normës së Interesit bazë (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2021);
- Ndryshime në standarde të ndryshme për shkak të "Përmirësimeve të SNRF (cikli 2018 -2020)" që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF (SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimeve (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9 dhe SNK 41 janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2022. Ndryshimi në SNRF 16 ka të bëjë vetëm me një shembull ilustrues, kështu që nuk deklarohet asnjë datë efektive).

Shoqëria ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde të reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja përpara datës kur hyjnë në fuqi. Shoqëria parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të veçanta të Shoqërisë në periudhën e zbatimit fillestar.

3.17 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin financiar të Shoqërisë në datën e raportimit (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së raportimit që nuk janë ngjarje rregulluese janë paraqitur në shënimet e pasqyrave financiare nëse janë materiale.

4. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR**4.1 Faktorët e rrezikut financiar**

Aktiviteti i Shoqërisë është i ekspozuar kundrejt disa rreziqeve financiare, kryesisht ndaj rrezikut nga kursi i këmbimit dhe rrezikut të likuiditetit.

Menaxhimi i rrezikut financiar bëhet nga drejtimi i Shoqërisë, duke u bazuar në disa politika e procedura të shkruara dhe të aprovuara paraprakisht, të cilat mbulojnë të gjithë menaxhimin e rrezikut të kursit të këmbimit dhe rrezikut të likuiditetit.

a) Rreziku nga kurset e këmbimit

Shoqëria kryen pjesën më të madhe të transaksioneve në monedhë të huaj dhe si pasojë është e ekspozuar ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit menaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Shoqëria disponon balanca të konsiderueshme në Euro si detyrim ndaj furnitorëve dhe palëve të lidhura, çfarë e ekspozon atë më shumë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Shoqëria disponon balanca të konsiderueshme në Euro të mjeteve monetare dhe ekuivalentët e tyre, si edhe balanca të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera.

Vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve monetare të Shoqërisë sipas monedhave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Më 31 dhjetor 2020	Euro	Lek	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	83,784,077	3,094,318	86,878,395
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	64,992,159	74,563,608	139,555,767
Totali i aktiveve financiare	148,776,236	77,657,926	226,434,162
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	(12,549,948)	(11,625,025)	(24,174,973)
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	(608,858,947)	-	(608,858,947)
Huamarje afatgjatë	(470,060,000)	-	(470,060,000)
Detyrimi për qiratë	(230,482,395)	-	(230,482,395)
Totali i detyrimeve financiare	(1,321,951,290)	(11,625,025)	(1,333,576,315)
Rreziku i kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2020	(1,173,175,054)	66,032,901	(1,107,142,153)
Më 31 dhjetor 2019	Euro	Lek	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	15,155,644	9,267,543	24,423,187
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	524,916	1,479,628	2,004,544
Totali i aktiveve financiare	15,680,560	10,747,171	26,427,731
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	(2,722,585)	(2,478,781)	(5,201,366)
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	(12,754,246)	-	(12,754,246)
Huamarje afatgjatë	(36,531,000)	-	(36,531,000)
Detyrimi për qiratë	(263,041,187)	-	(263,041,187)
Totali i detyrimeve financiare	(315,049,017)	(2,478,781)	(317,527,799)
Rreziku i kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2019	(299,368,457)	8,268,390	(291,100,068)

4. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)*b) Analiza e rrezikut të kursit të këmbimit*

Në administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit Shoqëria ka për qëllim të zvogëlojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Megjithatë, në periudhën afatgjatë, luhatjet e kursit të këmbimit mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në rezultat. Një analizë e ndikimit të ndryshimeve të vlerës së Lekut ndaj monedhës euro është paraqitur më poshtë. Analiza bazohet në ekspozimin ndaj kursit të këmbimit në datën e raportimit dhe ndryshimit të përcaktuar i cili ndodh në fillim të vitit financiar dhe mbahet konstant gjatë gjithë periudhës raportuese dhe supozuar se të gjithë faktorët e tjerë janë konstante.

	2020	2019
Monedha Euro zhvlerësohet me 10% kundrejt monedhës Lek	117,317,505	29,936,846
Monedha Euro vlerësohet me 10% kundrejt monedhës Lek	(117,317,505)	(29,936,846)

c) Rreziku i likuiditetit

Shoqëria i drejton nevojat e saj për likuiditet duke monitoruar me kujdes pagesat e detyrimeve të saj.

Pjesa më e madhe e detyrimeve janë përkundrejt shoqërisë mëmë, e cila nuk aplikon penalizime mbi vonesat në pagesa.


Për të përballuar efektivisht rrezikun e likuiditetit, Shoqëria ka nënshkruar një marrëveshje financimi me Shoqërinë mëmë për një linjë kredie me një limit deri në 5 milion euro, me afat 5 vjeçar.

Në këtë mënyrë, në rastet kur Shoqëria mund të përballlet me mungesë likuiditeti, ka të drejtë të përdorë fonde nga kjo linjë kredie me një limit të caktuar deri në 100 mijë euro për tërheqje dhe koha e lëvrimit të këtyre fondeve është brenda 5 ditëve nga momenti i paraqitjes së kërkesës nga Shoqëria.

Deri në 31 dhjetor 2020 Shoqëria ka përdorur 3,8 milion euro nga kjo linjë kredie.

Më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019, detyrimet financiare të Shoqërisë kanë maturime kontraktuale si më poshtë:

Më 31 dhjetor 2020	deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	86,878,395	-	-	86,878,395
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	66,569,759	72,986,008	492,438	140,048,205
	153,448,154	72,986,008	492,438	226,926,600
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	(19,854,459)	(613,179,461)	-	(633,033,920)
Hua nga mëma	-	-	(470,060,000)	(470,060,000)
Detyrimi për qiratë	(25,792,792)	(25,792,792)	(178,896,812)	(230,482,395)
	(45,647,251)	(638,972,253)	(648,956,812)	(1,333,576,315)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2020	107,800,903	(565,986,244)	(648,464,374)	(1,106,649,715)

T. Kadun


(te gjitha shumat jane te shprehura ne Lek)

4. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2019	deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	24,423,187	-	-	24,423,187
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	33,578	1,478,528	492,438	2,004,544
	24,456,765	1,478,528	492,438	26,427,731
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	(5,201,366)	(12,754,246)	-	(17,955,612)
Hua nga mëma	-	-	(36,531,000)	(36,531,000)
Detyrimi për qiratë	(18,401,921)	(18,401,921)	(226,237,345)	(263,041,187)
	(23,603,287)	(31,156,167)	(262,768,345)	(317,527,799)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2019	853,478	(29,677,639)	(262,275,907)	(291,100,068)

Sews – Cabind Albania Sh.p.k.
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)


5. Aktivet afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2020 janë të përbëra si mëposhtë:

Kosto	Makineri prodhimi	Instalime teknike dhe pajisje	Pajisje informatike	Të tjera	Mjete transporti	Pjesë këmbimi	Totali
Më 01 janar 2020	-	153,125	3,248,896	191,089	-	-	3,593,110
Shtesa	446,336,774	58,817,672	14,642,925	21,200,379	10,979,258	3,200,676	555,177,684
Më 31 dhjetor 2020	446,336,774	58,970,797	17,891,822	21,391,468	10,979,258	3,200,676	558,770,794
Amortizimi i akumuluar							
Më 01 janar 2020	-	-	(45,054)	-	-	-	(45,054)
Amortizimi i vitit	(21,252,405)	(5,811,038)	(2,742,352)	(1,872,926)	(879,785)	-	(32,558,505)
Më 31 dhjetor 2020	(21,252,405)	(5,811,038)	(2,787,405)	(1,872,926)	(879,785)	-	(32,603,559)
Vlera neto kontabël							
Më 01 janar 2020	-	153,125	3,203,843	191,089	-	-	3,548,057
Më 31 dhjetor 2020	425,084,369	53,159,759	15,104,416	19,518,542	10,099,473	3,200,676	526,167,235

Shpenzimet e amortizimit të alokuara në koston e mallit të shitur nën zërin e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit (nota 19) janë në shumën 5,341,118 lekë.

Asnjë aktiv afatgjatë material nuk është vendosur si kolateral ndaj financimeve me palë të treta në 31 dhjetor 2020.



6. Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2020 janë të përbëra si mëposhtë:

Kosto	Programe kompjuterike	Totali
Më 01 janar 2020	6,581,050	6,581,050
Shtesa	7,699,074	7,699,074
Më 31 dhjetor 2020	14,280,124	14,280,124
Amortizimi i akumuluar		
Më 01 janar 2020	(266,788)	(266,788)
Amortizimi i vitit	(1,830,513)	(1,830,513)
Më 31 dhjetor 2020	(2,097,301)	(2,097,301)
Vlera neto kontabël		
Më 01 janar 2020	6,314,262	6,314,262
Më 31 dhjetor 2020	12,182,824	12,182,823

Asnjë aktiv afatgjatë jo material nuk është vendosur si kolateral ndaj financimeve me palë të treta në 31 dhjetor 2020.

7. Aktivet me të drejtë përdorimi, neto

Aktivet me të drejtë përdorimi më 31 dhjetor 2020 janë të përbëra si mëposhtë:

Kosto	Ndërtesa	Automjete	Totali
Më 01 janar 2020	260,117,423	5,613,001	265,730,424
Më 31 dhjetor 2020	260,117,423	5,613,001	265,730,424
Amortizimi i akumuluar			
Më 01 janar 2020	(4,335,290)	(155,901)	(4,491,191)
Amortizimi i vitit	(52,023,485)	(1,870,813)	(53,894,298)
Më 31 dhjetor 2020	(56,358,775)	(2,026,714)	(58,385,489)
Vlera neto kontabël			
Më 01 janar 2020	255,782,132	5,457,100	261,239,233
Më 31 dhjetor 2020	203,758,648	3,586,287	207,344,934

Shpenzimet e amortizimit të alokuara në koston e mallit të shitur nën zërin e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit (nota 19) janë në shumën 10,924,932 lekë.

Shpenzimet e lidhura me qira afatshurtër (të përfshira në shpenzimet e tjera operative) kanë vlerën 393,769 lekë.

T. P. Sahin
Tate

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

8. Aktivet tatimore të shtyra

Aktivet tatimore të shtyra më 31 dhjetor 2020 janë të përbëra si mëposhtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Më 31 dhjetor 2019</u>
Aktivi tatimor i shtyrë (humbja fiskale)	13,238,114	886,882
Detyrim tatimor i shtyrë (amortizimi)	(29,808)	(3,898)
Total	<u>13,208,307</u>	<u>882,984</u>

Aktivi tatimor i shtyrë për aktivet afatgjata, lidhet me norma të ndryshme të amortizimit të aplikuar për qëllime kontabël dhe fiskale. Bazuar në rezultatet e parashikuara, Shoqëria vlerëson të ketë fitime në dispozicion në të ardhmen që do të përdoren për të rikuperuar humbjet e akumuluar. Për këtë arsye, është llogaritur gjithashtu një tatim i shtyrë për humbjet e mbartura që janë në dispozicion për tu rikuperuar në periudhat e ardhshme tatimore.

Më shumë detaje në lidhje me llogaritjen e tatimeve të shtyra janë paraqitur në pikën 3.12 të seksionit numër 3 “Politika të rëndësishme kontabël”.

9. Inventari

Zërat e inventarit më 31 dhjetor 2020 përbëhen nga sa mëposhtë:


	<u>Më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Më 31 dhjetor 2019</u>
Materiale të para	41,164,050	-
Produkte të përfunduara	16,189,628	-
Prodhim në proces	13,808,565	-
Materiale ndihmëse	84,377	-
Total	<u>71,246,620</u>	<u>-</u>

Gjatë vitit 2020, në kuadër të zhvillimit të aktivitetit të saj të prodhimit, Shoqëria ka importuar materiale të para për tu përdorur në procesin e prodhimit, nga janë realizuar produktet finale sipas kërkesave specifike nga klienti si dhe produkte të tjera gjysëm të përfunduara, të cilat më pas janë eksportuar tek klienti përkatës. Gjithashtu, në zërat e inventarit të Shoqërisë gjenden edhe materiale të tjera ndihmëse si edhe pjesë këmbimi të ndryshme.

10. Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit më 31 dhjetor 2020 përbëhen nga sa mëposhtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Më 31 dhjetor 2019</u>
Sews Cabind S.p.A	48,497,820	-
Sews Cabind Poland SP Z.o.o	15,848,096	-
Fjona 2006 Shpk	183,194	-
Total	<u>64,529,110</u>	<u>-</u>

T. B. Shew


11. Të drejta të arkëtueshme tatimore dhe të tjera

Të drejtat e arkëtueshme tatimore dhe të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 përbëhen nga sa mëposhtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Më 31 dhjetor 2019</u>
Tepricë kreditore e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar	72,781,576	1,478,528
Detyrime doganore të mbipaguara	184,432	-
Të drejta ndaj palëve të tjera të lidhura	126,000	-
Tatim mbi fitimin i parapaguar	20,000	-
Shpenzime për punonjësit për tu rifaturuar tek Shoqëria mëmë	20,000	33,578
Të drejta ndaj ortakëve për kontributet në kapital	121	121
Total	<u>73,132,129</u>	<u>1,512,227</u>

12. Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to më 31 dhjetor 2020 përbëhen si mëposhtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Më 31 dhjetor 2019</u>
Banka		
në valutë	83,784,077	15,155,644
në monedhë lokale	3,094,318	9,267,543
Total	<u>86,878,395</u>	<u>24,423,187</u>

Shoqëria zotëron mjete monetare dhe ekuivalentët e saj në llogaritë rrjedhëse bankare në euro dhe lekë pranë bankës Intesa Sanpaolo.

13. Huamarrje nga Shoqëria mëmë

Huamarrjet nga Shoqëria mëmë më 31 dhjetor 2020 përbëhet nga sa mëposhtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Më 31 dhjetor 2019</u>
Huamarrje nga Shoqëria mëmë	470,060,000	36,531,000
Total	<u>470,060,000</u>	<u>36,531,000</u>

Në kuadër të financimit të investimeve të saj në Shqipëri, Shoqëria ka nënshkruar një linjë kredie me shoqërinë mëmë Sews Cabind S.p.A, me një vlerë maksimale deri në 10 milion euro me një kohëzgjatje 5 vjet dhe me normë interesi prej 1.5%. Për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2020, Shoqëria ka përdorur 3,8 milion euro nga kjo linjë kredie. Gjithashtu, bazuar në marrëveshjen e financimit mes palëve, çdo detyrim i papaguar ose interes i përlllogaritur i pashlyer do të paguhet plotësisht në momentin më të hershëm nga: (a) kërkesa e huamarrësit; (b) 5 vjet nga data e fillimit të kësaj marrëveshje; ose (c) në rast së huadhënësi nuk kontrollon/zotëron më shumicën e kapitalit aksionar të huamarrësit.

T. Brahu
24
F20

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

14. Detyrimet për qiratë

	<u>Ndërtesa</u>	<u>Automjetet</u>
Detyrimi për qiranë më 01 janar 2020	257,451,290	5,589,897
Pagesa principali	(44,468,609)	(2,332,310)
Interesat	9,979,206	189,241
Rivlerësim nga kursi i këmbimit	3,988,429	85,251
Detyrimi për qiranë më 31 dhjetor 2020	<u>226,950,316</u>	<u>3,532,079</u>

Detyrimet për qiratë më 31 dhjetor 2020 përbëhen nga sa mëposhtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Më 31 dhjetor 2019</u>
<i>Detyrime afatgjata</i>		
Detyrime për qiranë për ndërtesën	177,257,644	222,770,364
Detyrime për qiranë për automjetet	1,639,167	3,466,981
Total	<u>178,896,812</u>	<u>226,237,345</u>
<i>Detyrime afatshkurtra</i>		
Detyrime për qiranë për ndërtesën	49,692,671	34,680,926
Detyrime për qiranë për automjetet	1,892,912	2,122,916
Total	<u>51,585,583</u>	<u>36,803,842</u>
Total	<u>230,482,395</u>	<u>263,041,187</u>

Në zbatim të SNRF 16, Shoqëria ka njohur edhe detyrimet e qirasë, të cilat janë rregjistruar me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, skontuar me normën e interesit të publikuar nga Banka e Shqipërisë për huamarrjen në euro për pasuritë e paluajtshme dhe blerje pajisjesh, me afat maturimi 3 deri në 5 vjet (përkatësisht 4.29% dhe 4.10%). Në datën e raportimit financiar, Shoqëria ka bërë riklasifikimin e detyrimeve për qiranë, duke ndarë për efekt paraqitje detyrimin afatshkurtër dhe afatgjatë të qirave.

	<u>Më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Më 31 dhjetor 2019</u>
Vlera e mbartur më 01 janar 2020	263,041,187	265,730,424
Shtesa	-	-
Interesat	10,168,447	1,609,147
Rivlerësim nga kursi i këmbimit	4,073,679	(2,288,972)
Pagesa	(46,800,918)	(2,009,412)
Vlera e mbartur më 31 dhjetor 2020	<u>(230,482,395)</u>	<u>(263,041,187)</u>

15. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit dhe të tjera

Të pagueshmet për aktivitetin e shfrytëzimit dhe detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2020 përbëhen nga sa mëposhtë:

<i>15.1 Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	<u>Më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Më 31 dhjetor 2019</u>
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	613,179,461	3,248,235
Të pagueshme ndaj palëve të treta	14,453,375	3,488,709
Total	<u>627,632,836</u>	<u>6,736,944</u>

15. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit dhe të tjera (vazhdim)

Llogaritë e pagueshme konsistojnë kryesisht në detyrimin ndaj palëve të lidhura për shpenzime të kryera gjatë fazës së investimit të Shoqërisë si dhe detyrime ndaj furnitorëve të tjerë për punime, shpenzime dhe shërbime të ndryshme. Shoqëria po nënshkruan një marrëveshje me Shoqërinë Mëmë për të netuar llogaritë e pagueshme tregtare me të arkëtueshmet kundrejt saj, prandaj detyrimet e pagueshme tregtare ndaj Sews Cabind S.p.A do të netohen me llogaritë e arkëtueshme ndaj këtyre të fundit.

16. Detyrime tatimore dhe të tjera

Detyrime tatimore dhe të tjera më 31 dhjetor 2020 përbëhen nga sa mëposhtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Më 31 dhjetor 2019</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	2,776,631	238,435
Tatim mbi të ardhurat personale	731,957	545,012
Tatim i mbajtur në burim	516,997	301,412
Detyrime ndaj punonjësve për shpenzime të rimbursueshme	19,944	184,604
Paga dhe shpërblime	16,984	-
Total	<u>4,062,513</u>	<u>1,269,463</u>

17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit


Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 përbëhen nga sa mëposhtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për periudhën nga 06 gusht deri më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga shitja e produkteve të përfunduara	48,113,251	-
Të ardhura nga shitja e materialeve të para	821,084	-
Të ardhura nga shitja e skrapit	16,392	-
Total	<u>48,950,727</u>	<u>-</u>

18. Të ardhura të tjera nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 përbëhen nga sa mëposhtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për periudhën nga 06 gusht deri më 31 dhjetor 2019</u>
Detyrime doganore të paguara nga eksportuesi	725,823	-
Të ardhura nga shitja e materialeve të tjera	167,601	30,254
Të ardhura të tjera	281,006	-
Total	<u>1,174,430</u>	<u>30,254</u>

26
T. Boplini


19. Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 përbëhen nga sa mëposhtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për periudhën nga 06 gusht deri më 31 dhjetor 2019
Kosto e mallit të shitur (materiale direkte) - Produkte të përfunduara	27,625,870	-
Kosto e mallit të shitur (punë direkte) - Produkte të përfunduara	21,769,106	-
Kosto e mallit të shitur (shpenzime të përgjithshme të prodhimit)	19,121,374	-
Kosto e mallit të shitur – Produkte gjysëm të përfunduara	563,144	-
Total	69,079,494	-

Në momentin e shitjes së elementëve të inventarit, Shoqëria ka njohur në shpenzime të periudhës vlerën kontabël të tyre, e cila në vetvete është e përbërë nga lënda e parë e përdorur në proceset e prodhimit për sistemet elektrike të automjeteve. Kësaj kostoje i është alokuar edhe kostoja e punës së punonjësve të angazhuar në mënyrë direkte në proceset e prodhimit të këtyre produkteve finale që u shitën gjatë periudhës. Gjithashtu, në koston e mallrave të shitur janë shpërndarë edhe shpenzimet e përgjithshme të prodhimit, të cilat në mënyrë indirekte janë lidhur me prodhimin e produkteve finale.

20. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 përbëhen nga sa mëposhtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për periudhën nga 06 gusht deri më 31 dhjetor 2019
Paga dhe shpërblime	31,592,196	6,924,611
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	6,559,803	335,553
Shpenzime të tjera për personelin	847,539	-
Total	38,999,538	7,260,164

7.27.2020
Reto

21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 përbëhen nga sa mëposhtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për periudhën nga 06 gusht deri më 31 dhjetor 2019
Shërbime trajnimi për punonjësit	65,152,958	-
Shërbime të konsulencës teknike	11,368,958	1,517,539
Shpenzime të tjera operative	7,340,955	416,459
Shërbime sigurie	5,988,000	500,000
Shërbime të konsulencës fiskale	5,203,648	682,872
Shpenzime për pjesë këmbimi	4,175,931	-
Shërbime ligjore	3,036,900	1,134,253
Shërbime pastrimi dhe gjëlberimi	2,276,371	-
Blerje materiale për makineri specifike	2,519,349	-
Shpenzime për uniformat dhe veshje të tjera specifike për punonjësit	1,798,287	-
Shërbime të konsulencës IT	1,639,173	-
Shërbime të konsulencës specifike	1,456,716	-
Shpenzime telefoni	1,420,891	83,550
Shpenzime të tjera për punonjësit	1,378,366	934,151
Shpenzime për energji elektrike	1,324,154	-
Shpenzime për materiale të pajisjeve IT	1,286,279	-
Shpenzime transporti (për shitje)	1,174,723	-
Shpenzime mirëmbajtje software	752,996	-
Shpenzime transporti (për blerje)	605,253	-
Shpenzime udhëtimi për punonjësit	585,170	838,092
Shpenzime karburanti	389,272	155,200
Shërbime të burimeve njerëzore	159,796	2,208,934
Total	121,034,147	8,471,050

Shpenzime të tjera operative përfshijnë shpenzime të ndryshme të përbaluara nga Shoqëria dhe kryesisht përbëhen nga shpenzime trajnimi, konsulencë teknike, fiskale dhe ligjore si dhe shpenzime të tjera.

22. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare (neto)

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare (neto) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 përbëhen nga sa mëposhtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për periudhën nga 06 gusht deri më 31 dhjetor 2019
<i>Shpenzime interesi</i>		
Interesa për qiratë (SNRF 16)	10,168,447	1,609,147
Interesa për huanë nga Shoqëria mëmë	3,835,918	137,036
Total	14,004,365	1,746,183
<i>Të ardhura nga këmbimet valutore</i>		
Fitim nga këmbimet valutore	(32,434,266)	(2,605,183)
Humbje nga këmbimet valutore	40,015,734	186,466
	7,581,468	(2,418,717)
Total	21,585,833	(672,534)

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

23. Shpenzimi për tatimin mbi fitimin


Shpenzimi i tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 është si mëposhtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për periudhën nga 06 gusht deri më 31 dhjetor 2019
Humbja e vitit	(272,591,121)	(19,831,459)
<i>Rregullime për qëllime kontabël:</i>		
Shpenzime te panjohura	8,822,855	1,481,653
Humbja tatimore	(263,768,266)	(18,349,806)
Humbje e mbarur	(18,349,806)	-
Shpenzim tatim fitim (5% per 2020)	-	-
Shpenzim tatim fitim i shtyrë	12,325,323	882,984
Parapagime të tatimit mbi fitimin	20,000	-
Tatim mbi fitimin për tu paguar	-	-

Rakordimi ndërmjet normës tatimore efektive dhe normës tatimore të përdorur për qëllime kontabël paraqitet mëposhtë:

		Norma tatimore efektive për 2020	
		2020	2019
Humbja para tatimit		(272,591,121)	(19,831,459)
Norma e tatimit	5%	(13,629,556)	(2,974,719)
Efekt i tatimit i shpenzimeve të panjohura	0%	441,143	222,248
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	5%	(13,188,413)	(2,752,471)

Duke filluar nga 1 janari 2020, norma e aplikueshme e tatimit mbi fitimin për personat juridikë që operojnë në industrinë automotivë është 5% e të ardhurave të tatueshme. Shoqëria plotëson të gjitha kriteret e ligjit për të zbatuar normën e reduktuar prej 5%. Për më tepër, bazuar në paketën fiskale të prezantuar në vitin 2020, personat juridikë që kryejnë investime me vlerë mbi 1 miliardë lekë, kanë gjithashtu të drejtën të mbartin humbjet fiskale për një periudhë deri në 5 vjet. Duke qenë se Shoqëria plotëson kriteret e mësipërme, ajo ka të drejtë të mbartë humbjen fiskale të treguar më sipër për një periudhë deri në 5 vjet.

T. 29


Sews – Cabind Albania Sh.p.k.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)***24. Transaksionet me palët e lidhura**

Transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë si mëposhtë:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
<i>Të drejta ndaj palëve të lidhura</i>		
Sews Cabind S.p.A	48,497,820	33,578
Sews Cabind Poland SP Zoo	15,848,096	-
Totali	64,345,916	33,578
<i>Të pagueshme ndaj palëve të lidhura</i>		
Sews Cabind S.p.A	534,727,548	3,248,235
Sews Cabind Poland SP Zoo	75,835,739	-
Totali	610,563,286	3,248,235
<i>Fonde të marra hua</i>		
Sews Cabind S.p.A	470,060,000	36,531,000
Interesa	2,616,175	-
Totali	472,676,175	36,531,000
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për periudhën nga 06 gusht deri më 31 dhjetor 2019
<i>Blerje aktivesh</i>		
Sews Cabind S.p.A	461,292,027	9,829,946
Sews Cabind Poland SP Zoo	821,906	-
Totali	462,113,933	9,829,946
<i>Të ardhura nga palët e lidhura</i>		
Sews Cabind S.p.A	48,207,543	-
Sews Cabind Poland SP Zoo	1,729,478	30,254
Totali	49,937,021	30,254
<i>Shpenzime të tjera me palët e lidhura</i>		
<u>Sews Cabind S.p.A:</u>		
Shpenzime interesi	3,835,917	137,036
Blerje e materialeve të para dhe produkteve të përfunduara	73,138,331	-
Shpenzime për punonjësit dhe të tjera për t'u rifaturuar	27,218,592	3,198,552
Taksa doganore për t'u rifaturuar dhe të tjera	7,232,051	249,856
<u>Sews Cabind Poland SP Zoo:</u>		
Blerje e materialeve të para dhe produkteve të përfunduara	10,660,165	-
Shërbime trajnimi për punonjësit	64,971,190	-
Totali	187,056,246	3,585,444

25. Angazhimet dhe Pasiguritë

Nuk ka angazhime dhe pasiguri që kërkojnë paraqitje ose korigjim në pasqyrat financiare.

26. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që kërkojnë veprime rregulluese ose shënime shpjeguese përveçse sa detajuar më lart.

SEWS – CABIND ALBANIA SH.P.K

**Raporti i audituesit të pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe për
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

T. Carlucci
12/20


PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E PERFORMANCËS DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5 - 30

T. Isahovic


RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin dhe Drejtimin e SEWS-CABIND ALBANIA sh.p.k.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të SEWS-CABIND ALBANIA sh.p.k. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2020, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar Auditimit (SNRF).

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të veçanta të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

